



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Procesverbali i dëgjimit publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028 në fshatin Orllan

Data: 04.06.2025

Podujevë

Të dhënat e përgjithshme

Ky procesverbal është hartuar në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligjit për Financat Publike, Statutit të Komunës së Podujevës dhe duke ndjekur standardet e Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në komuna.

Ky procesverbal përmban një përmbledhje të redaktuar të procesit të zhvilluar gjatë dëgjimit buxhetor. Palët që kanë vërejtje në përmbajtjen e tij mund të dërgojnë kërkesë për ndryshim deri më datë 20.06.2025, në adresën e emailit: info.podujeva@rks-gov.net

Procesverbali është dokument publik i hartuar në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Ligjin për Klasifikimin e Dokumenteve Zyrtare.

Hartuesi ka redaktuar të dhënat personale të mbledhura gjatë procesit, të cilat janë të arkivuara në komunë. Vetëm palët e autorizuara kanë qasje në këto të dhëna.

Dokumenti përmban të dhëna për fazën përgatitore të dëgjimit, përmbledhjen nga takimi dhe në aneks përfshihen materialet e bashkëngjitura të grumbulluara gjatë këtij procesi.

Veprimet para nisjes së takimit

Para fillimit të diskutimit, pjesëmarrësit janë regjistruar në listën përkatëse duke dhënë emrin, mbiemrin, numrin e telefonit dhe nënshkrimin e tyre. Të dhënat janë mbledhur për të dëshmuar pjesëmarrjen në dëgjimet e Kornizës Afatmesme Buxhetore.

Është konstatuar se për organizimin e këtij takimi nuk ka pasur nevojë për përkthyes apo interpret për persona me aftësi të kufizuara.

Zhvillimet gjatë takimit

Takimi filloi në ora 18:15.

Të pranishëm ishin:

- ***Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani***
- ***Drejtoresha e Administratës, Valbona Ibishi***
- ***Zëdhënësi***

Në takim morën pjesë gjithsej 25 pjesëmarrës (të gjithë burra).

(Shih në aneks: fotografitë dhe lista e pjesëmarrësve)

Fjalimi hyrës nga drejtori i Financave

Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Fatlum Osmani, hapi zyrtarisht dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2026–2028 në ambientet e Shkollës Filllore të Mesme të Ulët “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan.

Përmbledhje nga fjalimi:

“Të nderuar qytetarë, në emër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe hap zyrtarisht dëgjimet publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2026–2028 për Komunën e Podujevës.

Ky dokument strategjik përcakton prioritetet financiare të komunës në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe objektivat zhvillimore.

Procesi përgatitet në përputhje me Qarkoren Buxhetore 2026/01 të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, e cila përcakton udhëzimet dhe kufijtë fillestarë për hartimin e buxhetit.”

Limite buxhetore fillestare për vitin 2026 për Komunën e Podujevës:

- ***Granti i përgjithshëm: 14,627,269 €***
- ***Granti për arsim: 13,690,040 €***
- ***Granti për shëndetësi: 3,687,591 €***
- ***Shërbimet rezidenciale: 230,000 €***
- ***Financimi i teatrove: 185,729 €***
- ***Të hyrat vetanake: 2,358,325 €***

Totali i planifikuar: 34,778,954 €

Prioritetet e KAB-it Komunal përfshijnë:

- ***Ngritjen e cilësisë së arsimit dhe lidhjen me tregun e punës***

- *Zhvillimin e infrastrukturës urbane dhe rurale*
- *Përmirësimin e shërbimeve shëndetësore*
- *Zhvillimin ekonomik vendor dhe bujqësor*
- *Barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale*
- *Planifikimin shumëvjeçar të projekteve kapitale*

Korniza është hartuar sipas strukturës kontabël dhe parimeve të buxhetimit të orientuar në performancë, përfshirë komponentin gjinor dhe indikatorët e rezultateve për secilin program.

“Ky dëgjim publik është mundësi për qytetarët që të kontribuojnë në përfaqësimin e drejtë të prioriteteve buxhetore. Vetëm përmes përfshirjes suaj të drejtpërdrejtë mund të ndërtojmë një buxhet të drejtë dhe gjithëpërfshirës.”

Pas fjalimit, drejtori Osmani hapi diskutimin me qytetarët për të marrë kërkesat dhe rekomandimet e tyre.

Kërkesat nga pjesëmarrësit në dëgjim publik

Naim Bajrami

- *Ndërtimi i sallës së edukatës fizike*
- *Fasadimi i shkollës*
- *Rregullimi i kanalizimit*
- *Mbjellja e drunjve dekorativë*
- *Ndërtimi i trotuarit*
- *Ndërtimi i çerdhes*

- *Vendosja e kamerave në shkollë*
- *Rregullimi i hyrjes së shkollës*
- *Vibrimi i rrugës*

Fahri Retkoceri

- *Rregullimi i rrugës në Bllatë*

Ruzhdi Durmishi

- *Rregullimi i rrugës Bllatë–Metergoc*

Arben Musa

- *Ulëse në oborrin e shkollës*
- *Kënd lojërash për fëmijë*
- *Rregullimi i kanalizimit*
- *Kërkesë për impiant për ujërat e zeza*
- *Mirëmbajtja e hapësirave përreth liqenit*
- *Ndërtimi i banjove publike*
- *Zgjatja e orarit të punës në ambulancë (me dy ndërrime)*
- *Kamera dhe ndriçim te penda*
- *Furnizimi me ujë nga ujësjellësi*
- *Rregullimi i rrugës Orllan–Ballaban*
- *Rregullimi i rrugës për Metergoc*
- *Rregullimi i rrugës Kushevicë–Prishtinë*
- *Rruga për Muhazeb*
- *Plan rregullativ për ndërtimin në Orllan*

Ilaz Sahiti

- ***Rregullimi i rrugës Kushevicë–Nishec***
- ***Vendosje e tabelave sinjalizuese***

Shefki Zeqiri

- ***Asfaltim në Brainë (20 metra)***
- ***Rruga “Ismail Xhela” dhe “Sami Xhela”***

Hekuran Mehmeti

- ***Asfaltimi i rrugës “Elhami Dili”***

Fadil Neziri

- ***Asfaltimi i rrugës në Metergoc (950 m)***
- ***Asfaltimi i rrugës në fshatin Muhazob (1.5 km)***

Qamil Zeka

- ***Asfaltimi i rrugës “Guri i Halitit” në Metergoc (500 m)***

Drejtori Osmani u përgjigj në disa prej kërkesave dhe njoftoi se pas përfundimit të të gjitha dëgjimeve publike, do të publikohet raporti përmbledhës me të gjitha kërkesat e evidentuara nga grupi punues. Raporti do të jetë i qasshëm në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Podujevës.

Mbyllja e takimit

Takimi përfundoi në ora 19:45.

Në këtë dëgjim publik kontribuan me pjesëmarrje 25 persona, me 33 kërkesa të regjistruara.

Gra	0
Burra	25
Totali	25

Procesmbajtësja,

Liridona Rrahmani





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2026-2028, në fshatin Orllan

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1.	Alban Heketi	Orllan	
2.	SHARP SARMAN	ORLLAN	
3.	SHARIT HAXHIV	KUSHEVIGË	
4.	ILAZ HALITI	KUSHEVIC	
5.	Qosim Bani	Orllan	
6.	ARDE N MUSA	ORLLAN	
7.	HERVEAN-M MEHMUTI	ORLLAN	
8.	Gani Muso	ORLLAN	
9.	Ruzhdi Qurmishi	Ketargoc	
10.	FAOIL NEZIRI	METEGOC	
11.	Bashim Bilalli	Metegoc	
12.	MENTOR RAMAZANI	ORLLAN RE. EKONOMIK NR 84 197	
13.	Bekim Jekupi	Orllan Pr. Ekonomik Dillim 78 197	
14.	Samir Zeka	Ketargoc	
15.	Shefqet Zogaj	Bredoc	
16.	SPAKR KALLA	ORLLAN	
17.	Valmir Jlli	ORLLAN	
18.	Enver Azizi	Muhagoc	
19.	Sabit Zulla	Orllan	
20.	Bejta Zulla	"	

21. BESHIR MUSA

ORLLAN

22. ENR ABASHI

ORLLAN

23. NAFIZI HASANI

Orllan

Podujevë: 04.06.2025

24. AGRON Zeka

ORLLAN

25. BUJAR AZEMI

ORLLAN

26

27